

Nr. 72/1 Prot.,

Datë 08.12.2023

**PROCESVERBAL I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQËRISË AKSIONARE
"Rubicon" SHA
NIPT M02129014T**

Më 08.12.2023 në orën 15:30 sipas Njoftimit për Thirrje të dërguar nga aksionari i shoqërisë Z. Igli Gjelishti, në zbatim të pikës 9.6 të statutit të shoqërisë, nëpërmjet postës elektronike në datën 05.12.2023, ku i është propozuar Aksionarëve që në bazë dhe për zbatim të nenit 9.11 kjo mbledhje Asambleje e shoqërisë "Rubicon" SHA, me NIPT M02129014T (këtu e më poshtë referuar shkurt si "Shoqëria") të mbahet nëpërmjet videokonferencës në platformën Microsoft Teams.

Merr fjalën kryetari i mbledhjes, në bazë të nenit 9.10 të Statutit të shoqërisë, i cili iu uron mirëseardhjen pjesëmarrësve në mbledhje dhe u kërkon që të shprehin vullnetin e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të Asamblesë së Përgjithshme virtualisht nëpërmjet videokonferencës në platformën Microsoft Teams, si dhe duke dhënë dakordësinë për zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjes, pavarësisht faktit që është thirrur brenda një afati më të shkrutër se ai 20 ditor. Rolin e sekretarit të mbledhjes e mbajti z. Eno Kotmilo.

Më pas kryetari i mbledhjes së Asamblesë kryen verifikimet përkatëse dhe të gjithë të pranishmit, bazuar në nenin 138 pika 4 të ligjit për shoqëritë tregtare dhe nenin 9.9 të Statutit të shoqërisë, unanimisht pranojnë zhvillimin e mbledhjes pavarësisht pavarësisht respektimit të formaliteteve të thirrjes, si dhe kryerjen e saj nëpërmjet videokonferencës në platformën Microsoft Teams.

Për vendimet (të cilat konsiderohen të zakonshme) të cilat përmban rendi i ditës, sipas pikës 10.1 të statutit, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të zakonshme me praninë Aksionarëve që zotërojnë me shumë se 30% të aksioneve. Kryetari i mbledhjes së Asamblese dhe Sekretari i

Mbledhjes identifikojnë aksionarët që janë prezent:

1. Z. Altin Leksani, shtetas shqiptar, lindur më 06.05.1971 në Tiranë, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Kartës së Identitetit nr. HI 0506051 E;
2. Z. Igli Gjelishti, shtetas shqiptar, lindur me 14.07.1984 në Lushnje, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Kartës së Identitetit nr. I407104060P;
3. Z. Arian Syknej, shtetas shqiptar, lindur me lindur 02.01.1965 në Tiranë banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. G50102051V, perfaqesuar me autorizim nga zj. Alisa Syknej
4. Z. Eduard Hoxha, shtetas amerikan, lindur me 20.04.1980 me Shqiperi, banues ne Shetet e Bashkuara te Amerikes, mbajtes i Pasaportes me NR. 655341789 perfaqesuar me autorizim nga z. Eno Kotmilo
5. Znj. Aljula Hasa, shtetas shqiptar, lindur me lindur 14.06.1979 në Peshkopi, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. H95614008R perfaqesuar me autorizim nga z. Ardian Hasa.

NIPT M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

6. Z. Armand Brahaj, shtetas Gjerman, i lindur me 06.09.1979, në Rubik, Rrëshen, Shqipëri, me banim në Gjermani, identifikuar me Pasaportë me numër personal L8RY7VF24;
7. Z. Denis Behluli, shtetas shqiptar, lindur me lindur 14.06.1975 në Tirane, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. H50614066G
8. Z. Alfons Muçaj, shtetas hollandez, lindur me 13.08.1980 me Sinanaj, banues ne Holland, mbajtes i Pasaportes me NR. NWD48H3C6
9. Z. Eno Kotmilo, shtetas amerikan, lindur më lindur 13.08.1981 në Shqipëri, banues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbajtës i Pasaportës nr. 505478330;
10. Znj. Julia HOXHA, shtetase shqiptare, lindur me 27.03.1982, në Fier, me banim në Gjermani, mbajtese e kartes me numer BR6653716;
11. Shoqëria APC INTEGRATED LLC, me numer 463653788, me adrese ne 176 NEPONSET AVE, Dorchester, MA - USA perfaqesuar ne kete Kontrate nga Z. Olti Gjura shtetas amerikan, lindur me lindur 12.10.1978 në Tiranë, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. 585401335
12. Shoqëria NAVY YARD CAPITAL LLC, me numër 3908001 me adresë ne 651 N Board St., Suite 206 Middletoën - USA perfaqesuar nga Z. Gjergj Dollani shtetas amerikan lindur më 20.06.1978 në Durrës mbajtës i Pasaportës me nr. 501682440;

Kryetari i mbledhjes së Asamblesë për identifikimin e personave të sipërpërmendur ka marrë nën administrimin e tij paraprakisht Kartat e Identitetit dhe Pasaportat e Aksionarëve të depozituara më parë pranë shoqërisë, të cilat do t'ia bashkëlidhë rregullisht këtij vendimi.

- Platforma e zgjedhur për të zhvilluar videokonferencën Microsoft Teams përmbush të gjitha kërkesat ligjore të kërkuara në nenin 9.11 të Statutit dhe Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, përkatësisht aksionarët pjesëmarrës është e mundshme që të identifikohen qartazi, aksionarëve iu jepet mundësia në kohë reale që të ndjekin diskutimet e zhvilluara dhe të arrijnë të marrin pjesë në kohë reale në trajtimin e çdo çështjeje që diskutohet. Gjithashtu, Aksionarëve iu jepet mundësia që të votojnë drejtpërdrejtë mbi çështjet e rendit të ditës si me shprehje të vullnetit dhe me ngritje dore.
- asambleja e mbledhur në kushtet e nenit 9.11 te Statutit do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari i mbledhjes së Asamblesë dhe Sekretari i Mbledhjes. Procesverbali i mbajtur për këtë mbledhje ku do te pasqyrohen ngjarjet e ndodhura, diskutimet e kryera si dhe qëndrimet/votimet e mbajtura nga Aksionarët për çështjet objekt të rendit të ditës do të nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes së Asamblesë dhe Sekretari i Mbledhjes. Kryetari i mbledhjes së Asamblesë dhe Sekretari i Mbledhjes mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e procesverbalit në mënyrë të rregullt si dhe të pasqyrimit dhe raportimit me vërtetësi të qendrimeve dhe komunikimeve nga Aksionarët.
- kryetari i mbledhjes së Asamblesë ka kryer rregullisht identifikimin e personave prezent duke konfirmuar me zë të lartë të dhënat e tyre në Karten e Identitetit/ Pasaportën.
- në lidhje me verifikimin e kuorumit të kërkuar nga ligji dhe statuti, konstaton se për këtë janë prezent virtualisht të gjithë aksionarët e shoqërisë, të cilët bashkërisht janë mbajtës të 100% të aksioneve të shoqërisë.
- Në bazë të Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, konstatohet se kuorumi për të marrë vendime është arritur.
- Njoftimet, komunikimet dhe autorizimet për pjesëmarrjen në këtë Asamble do të mbahen bashkë me aktet e tjera të shoqërisë.

NUIS M 02129014 T



Rubicon Sh.A

Pas përmbushjes së gjithë formaliteteve ligjore, drejtuesi i mbledhjes së Asamblese konstaton se në këtë Mbledhje Asambleje, është plotësuar kushti për kuorumin dhe vendimet e marra prej saj janë të ligjshme e të vlefshme, në përputhje me Ligjin Nr.9901 dhe Statutin e shoqërisë.

Sekretari i mbledhjes së Asamblesë kështu kalon në trajtimin e pikave të rendit të ditës:

1. Shprehje opinionesh mbi njoftim për shitjen e aksioneve që përfaqësojnë 15,5205% të kapitalit të shoqërisë nga aksionari Armand Brahaj me vlerë 35,954,790.3 lekë drejt shoqërisë "Image & Communications Development" shpk, nëse asnjë nga aksionarët nuk ushtron të drejtën e parablerjes. Njoftimi i Transferimit ka ndjekur gjithashtu procedurën e parashikuar nga neni 7 i Statutit.
2. Vlerësimi i propozimit financiar të ardhur nga shoqëria "Image & Communications Development" shpk nëpërmjet zmadhimit të kapitalit të shoqërisë - Shoqëria aktualisht ka një kapital ligjor prej 113.241.854 (njëqind e trembëdhjetë milion e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) Lekë, i përbërë nga 113.241.854 (njëqind e trembëdhjetë milion e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) aksione, me vlerë nominale 1 Lek për aksion. Objekti i këtij operacioni është zmadhimi i kapitalit përmes emetimit të 105.034.657 (njëqind e pesë milionë e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) aksioneve të reja të pagueshme në para, me vlerë totale 130 885 000 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) Lekë, zmadhim i cili konsiderohet nga aksionarët si i domosdoshëm për përmirësimin e pozicionit financiar të shoqërisë, si dhe rritjen e mundësive të biznesit për "Rubicon" SHA. Zmadhimi i kapitalit të do të bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në regjistrin tregtar dhe në ditën e nesërme të publikimit shoqëria do të procedojë me emetimin e aksioneve dhe vënien e tyre në dispozicion për shitje. Aksionarët aktualë ose/dhe ata që mund të bëhen aksionarë shoqërie në përputhje me pikën 2 të rendit të ditës së kësaj mbledhjeje asambleje, jo më vonë se 20 ditë pas publikimit në regjistrin tregtar të këtij vendimi, kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve të reja që do të emetohen, në përpjestim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Këto aksione të reja mund të paguhen me këste në kohë sipas një plani pagesash që i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë integrale e tij në aneksin nr. 1.
3. Në rast se këto aksione të reja nuk nënshkruhen/paguhen nga aksionarët e shoqërisë në përputhje përpjestimore me numrin e aksioneve që ata zotërojnë ose dhe deklarohet prej tyre se nuk mund ose nuk duan të nënshkruajnë apo paguajnë këto aksione të reja, kjo e drejtë u kalon aksionarëve të tjerë përpjestimisht.
4. Në rast se pas 20 ditëve nga publikimi në regjistrin tregtar, këto aksione nuk janë nënshkruar apo paguar nga asnjë prej aksionarëve, aksionet e emetuara janë lirisht të shitshme tek aksionarët apo palët e treta. Menjëherë pas shitjes së të gjitha aksioneve, administratori është i detyruar të bëjë publikimet përkatëse në regjistrin tregtar dhe regjistrin e aksionarëve.
5. Administratori të ngarkohet nga asambleja për të nënshkruar kontratën e shitjes së aksioneve të reja të emetuara me palën blerëse.
6. Në përfundim, kapitali ligjor i shoqërisë zmadhohet nga vlera 113.241.854 (njëqind e trembëdhjetë milion e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) Lekë në vlerën 244.126.854 lekë (dyqind e dyzet e katër milion e njëqind e njëzet e gjahtë mijë e tetëqind e



pesëdhjetë e katër) Lekë, ndërsa numri total i aksioneve zmadhohet nga 113.241.854 në 218.276.511, me vlerë nominale prej 1,11842933938045 Lekë secili aksion.

Në përfundim të mbledhjes, Asambleja, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Njoftimi i transferimit të aksioneve që përfaqësojnë 15,5205% të kapitalit të shoqërisë nga aksionari Armand Brahaj, merr shprehje mos-interesit të drejtës së parablerjes nga një numer aksionerësh në mbledhje. Aksionerët e tjerë do shprehen brenda 20 ditësh në protokollim me email sipas statutit dhe në vazhdim të njoftimit të transferimit.
2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja të pagueshme në para sipas planit të paraqitur nga aksioneri . Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari i mbledhjes duhet të njoftojnë vendimmarrjen në faqen e kompanisë dhe pranë QKB.
3. Shoqëria do të emetojë 105.034.657 (njëqind e trembëdhjetë milion e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) aksione të reja të pagueshme në para, me vlerë totale 130 885 000 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë), të pagueshme sipas planit të pagesave me këste dhe në kohë të parashikuara në Aneksin 1 që i bashkëlidhet si pjesë integrale këtij vendimi, në përputhje me nenin 113 pika 1, nenin 117 pika 3, neni 168 pika 4, nenet 168-174 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
4. Pas zmadhimit, kapitali ligjor i shoqërisë do të jetë 244.126.854 lekë (dyqind e dyzet e katër milion e njëqind e njëzet e gjahtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër) Lekë me vlerë nominale prej 1,11842933938045 Lekë secili aksion.
5. Autorizohet Administratori i shoqërisë, që të nënshkruajë kontratën e shitjes së aksioneve të reja të emetuara me blerësin përkatës sipas kushteve të parashikuara në këtë vendim.

Kryetari i mbledhjes së Asamblesë fton të pranishmit të shprehin ndonjë opinion apo rezervë për sa më sipër miratuar, por asnjë i pranishëm nuk kishte diçka për të shtuar.

Sekretari i mbledhjes së Asamblesë falënderon sërish pjesëmarrësit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe njofton që një kopje e tij do iu dërgohet të gjithë Aksionarëve prezent në adresat e tyre të emailit, pasi të përfundojnë formalitetet e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të mbledhjes së Asamblesë dhe Sekretarit të saj. Kopjet origjinale të këtij procesverbali do të administrohen rregullisht sipas kërkesave ligjore në fuqi.


KRYETARI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE

SEKRETARI

Altin Leksani




Eno Kotmilo



Aneks 1 - Plani i pagesave me këste

Muaji	Vlera
Muaji 1	3 165 000
Muaji 2	3 165 000
Muaji 3	13 165 000
Muaji 4	3 165 000
Muaji 5	3 165 000
Muaji 6	3 165 000
Muaji 7	3 165 000
Muaji 8	3 165 000
Muaji 9	3 165 000
Muaji 10	2 800 000
Muaji 11	2 800 000
Muaji 12	12 800 000
Muaji 13	2 800 000
Muaji 14	2 800 000
Muaji 15	2 800 000
Muaji 16	2 500 000
Muaji 17	2 500 000
Muaji 18	2 500 000
Muaji 19	2 500 000
Muaji 20	2 500 000
Muaji 21	2 500 000
Muaji 22	2 200 000
Muaji 23	2 200 000
Muaji 24	12 200 000
Muaji 25	2 200 000
Muaji 26	2 200 000
Muaji 27	2 200 000
Muaji 28	2 000 000
Muaji 29	2 000 000
Muaji 30	2 000 000
Muaji 31	2 000 000
Muaji 32	2 000 000
Muaji 33	2 000 000
Muaji 34	1 800 000
Muaji 35	1 800 000
Muaji 36	11 800 000



Delegim per pjesmarrje ne mbledhjen Asamblese se Pergjithshme te Rubicon Sh.a

Ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Rubicon Sh.a qe do te mbahet ne Teams Meeting me date **08 Dhjetor 2023 ora 15:30** per diskutimin e temave te meposhtme:

Agenda:

1. Votimi i dy Anetareve te Keshillit;
2. Njoftim i transferimit nga Armand Brahaj tek dev.al;
3. Vleresimi i termave financiar te Dev.al (alias per Image & Communications Development) per angazhim si aksioner dhe rritje kapitali;
4. Diskutime te tjera.


Une i nenshkruari, **Arian Syknej**, lindur dhe banues ne Tirane dhe mbajtes i Leternjofimit ID me numer personal G50102051V, aksionar ne Rubicon Sh.a.

Delegoj

Alisa Syknej, lindur ne Munich dhe banuese ne Belgjikë, mbajtese e pasaportës Belge me numër GB7150486, te me perfaqesoje mua ne lidhje me gjithe aksionet me te drejte te plote vote prane aksionareve ne mbledhjen e siperpermendur.

Firma e aksionarit:

Arian Syknej



Vendi dhe Data e firmsjes:

Tirane, 07 Dhjetor 2023

Delegim per pjesmarrje ne mbledhjen Asamblese se Pergjithshme te Rubicon Sh.a

Ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Rubicon Sh.a qe do te mbahet ne [Teams Meeting](#) me date **08 Dhjetor 2023 ora 15:30** per diskutimin e temave te meposhtme:

Agenda:

1. Votimi i dy Anetareve te Keshillit;
2. Njoftim i transferimit nga Armand Brahaj tek dev.al;
3. Vleresimi i termave financiar te Dev.al (alias per Image & Communications Development) per angazhim si aksioner dhe rritje kapitali;
4. Diskutime te tjera.

Une i nenshkruari, **Eduard Hoxha**, lindur dhe banues ne Tirane dhe mbajtes i pasaportes me numer BA0419049, aksionar ne Rubicon Sh.a.

Delegoj

Eno Kotmilo, lindur dhe banues ne Tirane dhe mbajtes i Leternjoftim ID me numër I10813057F, te me perfaqesoje mua ne lidhje me gjithe aksionet me te drejte te plote vote prane aksionareve ne mbledhjen e siperpermendur.

Firma e aksionarit:

Eduard Hoxha



Vendi dhe Data e firmsjes:

Tirane, 08 Dhjetor 2023

Delegim per pjesmarrje ne mbledhjen Asamblese se Pergjithshme te Rubicon Sh.a

Ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Rubicon Sh.a qe do te mbahet online me date 23 Nentor, 2023 ora 16:00 per diskutimin e temave te meposhtme:

Agenda

- Perfundimi i mandatit per anetaret e Boardit (dhe sugjerime per pozicione te reja);
- Financimi dhe situata aktuale;
- Diskutime.

Une e nenshkuara

Aljula Hasa, lindur ne Peshkopi dhe banuese ne Tirane dhe mbajtese e leternjoftimit me numer personal H95614008R aksionare ne Rubicon Sh.a.

Delegoj

Ardian Hasa, lindur ne Durres e banues ne Tirane dhe mbajtes I leternjoftimit me numer personal H90628195B

Te me perfaqesoje mua ne lidhje me gjithë aksionet me te drejte te plote vote prane aksionareve ne mbledhjen e siperpermendur.

Firma e aksionarit:

ALJULA HASA



Vendi dhe Data e firmsjes: **Tirane, 22 Nentor 2023**